



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 05.05.2020, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Lubinko Karaxhiq, Alban Hyseni, Doarsa Kica- Xhelili, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Blerta Deliu- Kodra, Hajdar Beqaj, Besnik Tahiri dhe Erxhan Galushi.

**Mungoi:** Artan Abrashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Adnan Rustemi, kryetar i komisionit.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Fjolla Sopa, Kuvend; Visar Morina, OSCE; Zhujë Binakaj dhe Elvis Krasniqi, GP-AAK; Aurora Mullatahiri, GLPS; Shefki Kastrati, NDI; Erdonitë Hebibi, EO; Albina Reçica, Naser Shala dhe Shkëlzen Bajraktari, AKKVP; Faton Fetahu, GP-PDK dhe Agnesa Haxhiu, KDI.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.04.2021;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2020;

4. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtarë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile;
5. Njoftim lidhur me shkresën nga Sindikata e nëpunësve të shtetit të viteve 90-ta dhe Sindikata e ish -policëve të viteve të 90-ta;
6. Formimi i Grupit punues për shqyrtimin e kërkesë për trajtimin e ligjshmërisë së Rregullores MD-nr-01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore;
7. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me caktimin e përfaqësuesit për përfshirje në grupin punues për hartimin e koncept dokumentit për zhvillimin e procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë;
8. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua njëzëri pa ndryshime nga anëtarët e komisionit.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19.04.2021**

**Kryetari** konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19.04.2021, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2020**

**Kryetari** paraqiti për shqyrtim raportin e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2020 dhe ftoi z. Naser Shala, që të paraqes raportin vjetor me një përmbledhje të përgjithshme për vitin 2020 përpara komisionit.

**Naser Shala** tha se agjencia ka vazhduar me zbatimin e mandatit të trashëguar të saj në njëren anë, pra, asaj të ish- Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Drejtorisë për Çështje Pronësore, ndërsa në anën tjetër ka vazhduar punën e saj lidhur me zbatimin e mandatit të saj kryesor, asaj të krahasimit dhe verifikimit të dokumenteve kadastrale. Sa i përket mandatit të krahasimit dhe verifikimit të dokumenteve kadastrale është e rëndësishme të theksohet se edhe gjatë këtij viti raportues nuk ka filluar procesi i kthimit të dokumenteve kadastrale nga Serbia ashtu siç parashihet me Marrëveshjen e Brukselit, ndaj për këtë arsye edhe gjatë vitit 2020 Agjencia nuk ka filluar së zbatuari këtë pjesë të mandatit të dhënë. Si rezultat i bisedimeve në Bruksel midis Kosovës dhe Serbisë është arritur marrëveshja e vitit 2011 për kthimin e dokumenteve kadastrale të vjedhura nga autoritetet e Serbisë në vitin 1999. Gjithashtu tha se element i kësaj marrëveshje ka qenë themelimi i agjencisë e cila do ta bënte zbatimin e kësaj marrëveshje, kështu që me datë 09.06.2016 Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe verifikim të Pronës. Qeveria pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit nr. 551/2017, ka inicuar plotësim- ndryshimin e ligjit për Agjencinë. Ndërkohë tha se ky projektligj disa herë është miratuar në Qeveri dhe dërguar në Kuvend, por për shkak të shpërbërjeve të Kuvendit deri tani ende nuk është miratuar. Gjithashtu u shpreh se miratimi i këtij

projektligjiti do të bëjë të mundur adresimin e të gjeturave të Avoktit të Popullit e që kanë të bëjnë me vazhdimin e administrimit të pronave, si dhe skemën e qirasë. Po ashtu miratimi i këtij projekligji do të bënte të mundur edhe adresimin e informalitetit, ashtu siç është shtjelluar në Strategjinë Kombëtare të Pronave.

Numri i përgjithshëm i dokumenteve kadastrale të skanuara dhe të indeksuara në Serbi e që priten të kthehen është 4,037,264. Të gjitha këto dokumente kadastrale për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare të vjedhura nga autoritetet e Serbise para qershorit të vitit 1999, do të pranohen, krahasohen me dokumentet kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës dhe përmes KVVP-së ( komisioni për verifikim dhe vendosje ) do të zgjidhen dallimet mes këtyre dy grupeve të dokumenteve. Lidhur me mandatin e ri është e ditur që Agjencia do të përballlet me sfida të mëdha. Ndoshta do të preken grupe të ndryshme të interesit të cilat grupe në periudha të caktuara kohore kanë përvetësuar prona të ndryshme shoqërore. Kjo dukuri ka vazhduar për një periudhë menjëherë pas luftës, ku me procedura të ndryshme pronat shoqërore kanë kaluar në ato private. Tha se janë përkushtuar si agjenci që me kthimin e dokumenteve kadastrale të bëjnë krahasimoin dhe verifikimin adekuat konform ligjit, dhe se vendimet e Komisionit për Krahasim dhe Verifikim të Pronës do të jenë të plotfuqishme dhe të gjithë janë të obliguar t' i zbatojnë në mënyrë që çështjet pronësore juridike në Kosovë sa i përket verifikimit të quhen të zgjidhura.

Përkundër situatës së vështirësuar nga Pandemia Agjencia ka vazhduar me aktivitetet e saja në përmbushjen e mandateve të trashëguara. Në kuadër të këtyre aktiviteteve kanë vazhduar me zbatimin e vendimeve të Komisionit për kërkesa pronësore dhe të Komisionit për kërkesa pronësore banesore. Ndërkaq, kanë vazhduar me inspektimin e pronave të cilat janë nën administrim e agjencisë rreth 12.000, si dhe kanë bërë inspektimet e rregullta për pronat nga skema qirasë ku menjëherë pas aprovimit të ligjit në Kuvend prona të përshtatshme për qiradhënie do të jenë 4000.

Ndër tjera tha se me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ 01//2000 për shkatërrimin e strukturave ilegale në prill të vitit 2020 nga Qeveria Kurti I, kanë filluar menjëherë me zbatimin e saj ku janë shkatërruar tri objekte. Në pritje për t'u rënuar janë 39 lëndë, që përfshijnë rreth 112 objekte në tërë territorin e Kosovës.

Gjithashtu kanë vazhduar me procesin e ndërmjetësimit në 19 raste të tjera. Ka vazhduar edhe procesi i lirimimit të pronave të uzurpuara përkatësisht dëbimeve me mbështetjen e policisë.

Në fund tha se mandati i agjencisë paraqet një kompetencë ekskluzive, e që nënkupton që përjashton gjykatat e rregullta nga trajtimi i çështjeve të trajtuara nga agjencia respektivisht Komisioni për kërkesa Pronësore apo Komisioni për Verifikim dhe Vendosje në Pronë.

**Alban Hyseni**, pyet se cilat janë arsyet për aprovim të këtyre ankesave dhe a mund të tregoni një prej tyre lidhur me këto ankesa, që janë aprovuar të vendimeve të gjykatës Supreme? Po ashtu pyet dhe kërkon sqarim në lidhje me administrimin e pronave bujqësore ku Peja dhe Gjilani prinë për nga numri më i madh gjithashtu edhe për numrin e përgjithshëm të inspektimeve të pronave nën administrim. Ndërkohë kërkoi sqarim se përse skema e qiradhënies vullnetare nuk është zbatuar për vitin 2019?

**Albina Reçica, AKKVP,** duke ju përgjigjur pyetjeve tha se kryesisht me ankesat, që nuk janë aprovuar kanë pasur të bëjnë me fakte shtesë të cilat janë prezantuar në dhomën e apelit pranë Gjykatës Supreme.

**Naser Shala, AKKVP,** tha se në kuadër të aktiviteteve të agjencisë kanë vazhduar me inspektimin e përgjithshëm të pronave të cilat janë rreth 12000, si dhe kanë bërë inspektimin e rregullt të pronave nga skema e qirasë ku menjëherë pas miratimit të ligjit, prona të përshtatshme për qira janë konsideruar rreth 4000.

**Besnik Tahiri** tha se ky institucion ka një rëndësi të jashtëzakonshme për shkak se lidhet drejtpërdrejt me çështjen fundamentale të shtetit e që është ajo e pronës. Po ashtu foli për zhvillimin ekonomik në komuna, që lidhet drejtpërdrejt me strategjinë kombëtare të pronës e cila është miratuar në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë, Komunat edhe me ambasadat që operojnë në Kosovë. Gjithashtu shtoi se kërkesat për zyrën kadastrale komunale për periudhën raportuese është 614 përderisa numri total i kërkesave është 8445. Problemi i madh në komuna lidhet me titullarin ku shumë persona kanë kërkuar përkthimin e tokave duke e ditur se libri kadastral është ende në shtetin fqinjë. Më tej shtoi se kompetencat, punën dhe angazhimin, që keni pas si agjenci t'ia mundësoni qytetarëve të Kosovës përkthimin e tokave në mënyrë, që këtë kapacitet të cilën e kanë ta kthejnë në zhvillim lokal. Ndërkohë, pyet se meqenëse strategjia kombëtare e pronës jua ka besuar këtë përgjegjësi a keni bërë diçka në këtë drejtim dhe a pritet një bashkëpunim më i ngushtë me komunat e Kosovës?

**Albina Reçica, AKKVP,** tha se strategjia kombëtare për të drejta pronësore e ka paraparë adresimin e informalitetit si një çështje me shumë rëndësi dhe me plotësim ndryshimin e ligjit agjencisë ju ka besuar një pjesë e këtij mandati sidomos periudhës së diskriminit 89-90 e deri në vitin 99. Po ashtu drejtorja e asaj kohe ka trajtuar një pjesë të transaksioneve joformale që kanë ndodhur gjatë kohës së diskriminit dhe ka vendos, me ç'rast palët kanë arritur ti legalizojnë shit-blerjet të cilat janë kryer në atë kohë. Gjithashtu tha se po presin miratimin e ligjit për të trajtuar edhe mandatin shtesë që do t'i jepet për pronat, por ndërkohë paraprakisht kanë filluar edhe me hartimin e infrastrukturës ligjore.

**Kryetari** tha se mandati i agjencisë për krahasim dhe verifikim të pronave është pranimi i dokumentacioneve të plaçkitura nga Serbia para qershorit të vitit 99, si dhe krahasimi i tyre me dokumentacionin e Republikës së Kosovës për zgjidhjen dhe mospërputhjen për pronat komerciale, bujqësore dhe banesore. Po ashtu tha se në lidhje me këtë fushëveprimtari themelore të agjencisë nuk është bërë asgjë, e cila është edhe çështje për diskutim sepse roli i komisionit është që të mbikëqyrë punën e agjencisë se a është përmbushur mandati ligjor apo jo. Gjithashtu pati vërejtje strukturore dhe teknike në lidhje me vitin e raportit të punës sepse ky raport ka të bëjë me vitin 2020 dhe jo me vitin 2019. Po ashtu në faqen 15 të raportit ku thuhet se bordi është takuar 0 herë gjatë periudhës së raportimit dhe pyet se a është ndonjë gabim teknik apo vërtet bordi nuk ka pasur asnjë takim?

**Shkëlzen Bajraktari** tha se bordi nuk është takuar asnjëherë sepse nuk ka qenë funksional. Në bazë të ligjit bordi përbëhet nga pesë anëtarë të bordit, 3 ndërkombëtarë dhe 2 vendorë. Në vitin 2020 deri në tetor kanë qenë vetëm 2 anëtarë ndërkombëtarë. Pra, në tetor është emëruar anëtari i tretë e cila

është ambasadorja suedeze në Kosovë për anëtare të bordit. Ndërkohë bordi kishte planifikuar të mbante mbledhje në dhjetor të vitit 2020, por për shkak të pandemisë u shty për janar të vitit 2021.

**Kryetari** pyet se sa është numri i ankesave të dërguar në Gjykatën Supreme, cilat kanë qenë arsyet e dorëheqjes së anëtarëve të komisionit për kërkesa pronësore të cilët kanë dhënë dorëheqje në vitin 2020?

**Shkëlzen Bajraktari, AKKVP,** theksoi se arsyet për dhënien e dorëheqjes kanë qenë për shkak të ligjit për parandalim e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pra, të qenit anëtar i komisionit për kërkesa pronësore dhe avokat paraqet konflikt interesi.

**Albina Reçica, AKKVP,** sa i përket ankesave kanë pranuar vetëm dy ankesa kundër vendimeve për kërkesa pronësore ku i kanë plotësuar kriteret dhe janë dërguar në Gjykatën Supreme. Ndërsa në Gjykatën Supreme është vendosur për 42 aktgjykime prej të cilave 39 janë refuzuar dhe vetëm tri janë miratuar dhe janë kthyer për riprosesim.

**Kryetari** pyeti se sa dëbime të uzurpuesve të paligjshëm nga pronat përkatëse kanë ndodhur në vitin 2020, sa kallëzime penale keni dërguar në prokurori, sa raste të ndërmjetësimit janë trajtuar në vitin 2020? Po ashtu te statistika për verifikimin e dokumenteve me theks të veçantë për Mitrovicë numri 7 është shumë shifër e ulët, marr parasysh problemet, që paraqiten në raport. Gjithashtu te numri i përgjithshëm i pronave të marra nën administrim sipas komunave bie në sy, që në komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçan shifrat janë shumë të ulta në krahasim me komunat tjera. Ndërkohë kërkoi sqarim në lidhje me numrin e dëbimeve në pritje sepse duket sikur ka shpërputhje me atë se çfarë është paraqitur në tabelë, me theks të veçantë për komunat veriore të Kosovës.

**Shkëlzen Bajraktari, AKKVP,** sa i përket dëbimeve agjencia në kuadër të mandatit ka vazhduar edhe në vitin 2020 duke pohuar se janë të përkushtur që lirimin e pronave ta bëjnë në bazë të ligjit, pa marrë parasysh përkatësinë etnike ose edhe anë regjionale. Janë 11 prona në skemën e kompensimit të cilat janë procedurë e sipër për të bërë kërkesë për riprocedimin e pronës dhe në momentin që merret kërkesa për riprocedim agjencia e shqyrton dhe vazhdon punën në terren me përkrahjen e policisë. Sa i përket kallzimeve penale kanë të bëjnë me ri-uzurpimin e pronave, por kur të bëhet plotësim-ndryshimi i ligjit lirimi i pronave mund të bëhet sa herë të paraqitet nevoja.

**Albina Reçica, AKKVP,** tha se kërkesa për administrim të pronës është kompetencë e palëve për ta kërkuar dhe përderisa pala nuk kërkon kthimin e pronën në posedim, agjencia nuk mund të ndër marrë ndonjë veprim.

**Kryetari** sërish pyet se cilat janë arsyet e dëbimeve të anuluar në Mitrovicën e Veriut dhe kallzimet penale të dërguar në prokurori për Mitrovicën e Veriut janë 0, dhe pyetja natyrshëm vjen a nuk ka pasur ri-uzurpime brenda 72 orëve apo cila është arsyeja? Sa prona janë të uzurpuara në veriun e Kosovës?

**Shkëlzen Bajraktari, AKKVP,** duke ju përgjigjur pyetjeve tha se anulimet bëhen vetëm me kërkesë të palëve, pra një anulim, një urdhër për dëbim mund të mbetet në procedurë, por nuk mund të anulohet pa kërkesë të palës. Sa i përket pronave të uzurpuara në veri të vendit nuk ka ndonjë shifër të saktë.

**Kryetari** kërkoi sqarim në lidhje me dy aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe ndaj kujt kanë qenë të adresuara këto ankesa?

**Albina Reçica, AKKVP,** tha se ankesat ka qenë të adresuara në Gjykatën Kushtetues kundër mos zbatimeve të vendimeve nga agjencia. Si pasojë e moszbatimeve të vendimeve ka qenë një mjet ligjor që agjencia është dashur ta zbatojë, pra ka qenë rrënimi i strukturave të paligjshme. Si rezultat i këtij mjeti juridik është hartuar një udhëzim administrativ ku është miratuar në Qeverinë Kurti 1. Me miratimin e këtij udhëzimi kanë arritur të bëjnë zbatimin e një vendimi dhe kanë bërë shkatërrimin e strukturave ilegale, kthimin e të drejtës pronësore tek paraqitësja e kërkesës e cila ka bërë ankesë në Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa për rastet e tjera të kësaj natyre palët pas miratimit të udhëzimit administrativ kanë hyrë në ndërmjetësim dhe po tentojnë në një marrëveshje jashtë aplikimit të këtij mjeti juridik. Po ashtu tha se agjencia i ka pasur 84 raste për të cilën është paraqitur kërkesa për rrënim, implementim i vendimit përmes rrënitimit të strukturave. Janë 112 objekte me gjithsej 39 lëndë ku agjencia duhet t' i rrënojë për t' i kthyer të drejtën pronësore dhe posedimin te paraqitësit e kërkesave për arsye se është arritur ndërmjetësimi, ndërsa 19 raste janë në proces të ndërmjetësimit. 24 raste kanë arritur **marrëveshje jashtë agjencisë.**

**Kryetari:** Çfarë është bërë me institucionet tjera apo edhe nga vet ju në raport me institucionet ndërkombëtare për t' u kthyer dokumentacioni kadastral në Kosovë sipas marrëveshjes?

**Naser Shala** tha se kjo çështje është më shumë politike sepse nuk mund të fillohet ky proces pa u kthye dokumentet nga Serbia.

**Kryetari** tha se Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës nuk është marrë me mandatin për të cilin edhe u themeluar dhe aktivitet, që janë kryer deri tani janë ana sipërfaqësore e institucionit.

**Hajdar Beqa,** sa i përket marrëveshjes së Brukselit për kthimin e dokumentacionit, kërkoi të dinte se çfarë varet nga Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës duke pohuar se kjo çështje duhet të diskutohet në Kuvend për t'ju adresuar Qeverisë në mënyrë që kjo çështje të diskutohet në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Propozoi, që të theksohet më shumë zbatimi i marrëveshjes së Brukselit ku obligohet Serbia t' i kthej dokumentet origjinale të skanuara kadastrale. Më tej pyet si vepron agjencia në rastet e pësëritura të ri-uzurpimit si problem penal ? Në fund kërkoi që të procedohet sa më shpejt ndryshim-plotësimi i ligjit sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

**Albina Reçica, AKKVP,** tha se te rastet, që kanë të bëjnë me ri-uzurpimet janë raste të cilat palët kanë qenë në proces në agjenci ku janë vërtetuar se ato nuk kanë të drejtë ligjore në ato prona. Po ashtu tha se gjykatat janë jo kompetente për të vendosur në kërkesat në cilën ka vendosur komisioni. Me miratimin e ligjit në Kuvend agjencia do të ketë në kompetencë ri-dëbimin e vazhdueshëm, pra jo

brenda 72 orëve, por sa herë të ri-uzorpoen pronat agjencia ka të drejtë të bëjë dëbime deri sa të vendosin pronarët e ligjshëm se çfarë do të bëjnë me pronat e tyre.

**Driton Selmanaj** tha se meqenëse mandati i Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është specifik, a ka orientime ose objektiva se kur do të përfudojë dhe të shuhet kjo agjenci sepse të presim Serbinë të sjellë dokumentet apo jo edhe pse janë 4 milionë dokumente, që do të shërbenin si dokumente kadastrale, por jo domosdorisht.

**Albina Reçica, AKKVP**, tha se ne nuk dimë se kur do të vinë dokumentet, ndaj edhe nuk mund të dinë se kur do të përfundojë mandati i Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Mandati i agjencisë është të identifikohet çdo dallim, çdo mospërputhje me dokumentet aktuale me dokumentet e marrura në vitin 1999. Dallimi dhe mospërputhje do të ketë shumë se brenda një familjeje janë bërë shumë ndryshime dhe shumë ndryshime të pronarëve të cilat do të krahasohen dhe vërtetohen nga agjencia.

**Doarsa Kica- Xhelili**, kishte paqartësi në lidhje me raportin sespe nuk ka detaje më të hollësishme, që mund të qartësojë më mirë raportin. Po ashtu tha se me sqarimet, që i morën sot nga raportimi i përfaqësuesve të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës propozoi që miratimi i këtij raporti të shtyhet për mbledhjen e radhës.

**Blerta Deliu- Kodra** tha se kjo çështja e miratimit apo mosmiratimit të raportit edhe nga e kaluara nuk ka ndonjë masë që e sanksionon, ndaj votimin e raportit mund ta lëmë edhe mbledhjen e radhës, por këto probleme janë përcjellë çdo legjislaturë.

**Hajdar Beqa** tha se në këtë fazë pas shterrjes së debatit nuk është e domosdoshme të shtyhet miratimi i raportit në mbledhjen tjetër.

**Kryetari** tha se pajtohet me znj. Deliu në kuptim se raportet u miratuan apo nuk u miratuan institucionet po mbesin në gjendjen e njëjtë, por vlerësimi i performancës apo vërejtjet duhet të evidentohen ndaj institucionit.

Pas diskutimeve *kryetari konstatoi se miratimi i raportit të punës për Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës shtyhet për mbledhjen e radhës.*

#### **4. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile**

**Kryetari**, ftoi kryesuesin e grupit të punës z. Alban Hyseni ta arsyetojë draftin e konkurseve për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile.

**Alban Hyseni** tha se grupi i punës i ka kryer punën e vet dhe drafti është përgatitur ku është ndjekur edhe praktikave e legjislaturave të kaluara.

**Blertha Deliu- Kodra**, tha se takimin e fundit nuk ka qenë prezent sepse nuk ka qenë e informuar duke pohuar se adresa e imelit, që i është dhënë administratës ka qenë gabim.

*Meqë nuk pati diskutime kryetari, konstatoi se komisioni një zëri nxorri këto:*

### **V E N D I M**

- I. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile, siç përcaktohet me nenin 9, paragrafi 3.3 dhe nenin 10, paragrafi 3 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
- II. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.
- III. Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit që është miratuar në komision.

### **V E N D I M**

Të shpallet konkursi për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Amendamenti nr. 25 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës), si dhe 1 (një) anëtar/e në Këshillin Gjyqësor, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

- I. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.
- II. Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit, që është miratuar në komision.

### **5. Njoftim lidhur me shkresën nga Sindikata e nëpunësve të shtetit të viteve 90-ta dhe Sindikata e ish- policëve të viteve të 90-ta**

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e komisionit në lidhje me shkresën nga Sindikata e nëpunësve të shtetit të viteve 90-ta dhe Sindikata e ish- policëve të viteve 90-ta dhe tha se kjo çështje nuk bie në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, por te Komisioni për buxhet, punë dhe transfere.

*Meqë nuk pati diskutime anëtarët e komisionit u pajtuan që kjo shkresë të dërgohet në Komisionit për buxhet, punë dhe transfere.*

### **6. Formimi i Grupit punues për shqyrtimin e kërkesë për trajtimin e ligjshmërisë së Rregullores MD-nr-01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore**

**Kryetari** propozoi që të formohet një grup i punës, që ta shqyrtojë këtë shkresë dhe Komisionit t' i paraqesë raport me rekomandime për veprime eventuale të mëtejshme.



**Hajdar Beqa** tha se nuk jemi kompetent si komision për ta trajtuar këtë çështje si komision për legjislacion.

**Driton Selmanaj** tha se kjo çështje nuk bie në mandatin tonë, por kjo i takon Qeverisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Po ashtu tha se nëse bëhet mbikëqyrja e zbatimit të ligjit ku përfshihet edhe kjo rregullore atëherë është në mandatin e Kuvendit.

**Blerta Deliu -Kodra** tha se përderisa është akt nënligjor atëherë i takon Ministrisë së Drejtësisë ta shqyrtoj dhe të merret me këtë kërkesë. Shqetësimet e tyre ishin organizative dhe shkelje e të drejtave.

**Besnik Tahiri**, po ashtu, tha se duhet të ketë një linjë hierarkike dhe roli i komisionit nuk është të japi interpretime.

*Pas diskutime anëtarët e komisionit u pajtuan që t'i kthehet një përgjigje Institutit të Mjekësisë Ligjore si më poshtë:*

Kjo çështje nuk është në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

#### **7. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me caktimin e përfaqësuesit për përfshirje në grupin punues për hartimin e koncept dokumentit për zhvillimin e procesit të Vetëingut në Sistemin e Drejtësisë**

**Kryetari** paraqiti për shqyrtim kërkesën nga Ministria e Drejtësisë lidhur me caktimin e përfaqësuesit për përfshirje në grupin punues për hartimin e koncept dokumentit për zhvillimin e procesit të Vetëingut në Sistemin e Drejtësisë. Po ahstu propozoi, përfaqësuesi i Komisionit për Legjislacion të jetë dikush nga opozita.

**Driton Selmanaj** tha se nuk është praktikë, që të përzihen pushtetet me njëra –tjetrën. Qeveria është ajo që propozon koncept- dokumente ku më pas i dërgohen Kuvendit. Përfshirja e Kuvendit në këtë fazë nuk do ishte mirë edhe për këtë sistem demokratik, që është ndërtuar.

**Besnik Tahiri**, tha se në qoftë se Qeveria kërkon ta bëjë hisedarë edhe Kuvendin atëherë si opozitë do duhej të dakordohej se kush do të propozohet për të qenë përfaqësuesi. Më tej tha se mbase do ishte shkurtuar rruga e debatit duke pas përfaqësuesin dhe propozoi Driton Selmanaj të jetë përfaqësuesi në grupin e punës për hartimin e koncept dokumentit për zhvillimin e procesit të Vetëingut në Sistemin e Drejtësisë.

**Hajdar Beqa** tha se në parim jam kundër që Kuvendi të kyçet në këtë fazë sepse pushtetet janë të ndara, megjithatë mbase mund të qëllimi i mirë i Ministres. Ndërkohë tha se nëse domosdosmërisht duhet pajtohen që shkoj në emër të opozitës Driton Selmanaj.

**Blerta Deliu- Kodra** tha se për herë të parë Qeveria në fazë e hartimit të koncept-dokumentit kërkon të përfshihet edhe Kuvendi. Kërkoi që përparja mbledhjes opozita të ketë një takim për të diskutuar në lidhje me këtë çështje sepse parimi është e shih si përzierje të pushteteve, ndërsa e përkrahu propozimin, që Driton Selmanaj të jetë përfaqësues nëse do duhej të shkonte.

**Kryetari** tha se procesi i Vettingut është proces gjithpërfshirës dhe nuk mendon që është përzierje e pushteteve. Është faza e fillestare analitike të përgatitjeve të modaliteteve nga një grup pune hetetregjen, që përfshin edhe institucione tjera shtetërore, shoqërinë civile dhe nuk do të kishte asgjë të keqe të përfshihet edhe komisioni për Legjislacion. Po ashtu tha se pajtohet që Driton Selmanaj të jetë përfaqësuesi por, edhe Besnik Tahiri sepse e shih si punë më shumë profesionale sesa politike.

**Besnik Tahiri** tha se pajtohet që opozita të diskutoj përpara se të dërgoj propozuesin e vet. Ndërkaq tha se do ishte mirë që të ndërtonin një konsensus politik, që në nisje të koncept dokumentit për vettingun sepse mbase është vonë deri sa të procedohet për Kuvend.

**Driton Selmanaj** tha se kjo temë nuk është e lehtë dhe është bukur komplekse. Më tej sqaroi komisionin e mëparshëm për vettingun ku shoqëria civile e kishte udhëhequr dhe grupi i punës për vettingun kishte ardhur me tre modalitete ku e para të mos prekej sistemi fare, e dyta të ketë sistem të kombinuar dhe e treta vetting klasik, siç ka ndodhur në vende tjera. Qeveria e asaj kohe kishte zgjedhur modelin e kombinuar. Përkundër vullnetit të mirë, që mund të ketë gjithpërfshirje, por si parlament involvohemi kur të vijë në kuvend dokumenti sepse i takon Vetëvendosjes si parti fituese të zgjedhë se cilin modalitet do të propozojë.

**Doarsa Kica- Xhelili**, tha se pikërisht prej stërtrajtimin të çështjes së vettingut prej krejt partive politike pa përjashtim konfirmohet rëndësia esenciale e këtij ligji. Po ashtu tha se nuk pajtohet për mos shkuar për të mirën e përgjithshme qoftë edhe dhënia e një kontributi që në fazën fillestare. Natyrisht secili përfaqësues i opozitës mund të distancohet për çfarëdo qëndrimi, që mund të mirret në atë grup pune. Gjithashtu tha se e shih qënësore pjesëmarrjen e një përfaqësuesi me memorje institucionale për këto qëllime dhe e dyta e shih qënësore në aspekt të diferencimit të perceptimeve në lidhje me këtë ligj sepse në fund të fundit ligjet e mira bëhen me kundërshtime dhe jo me pajtime.

**Besnik Tahiri**, në fjalën e tij të sërishme ndër tjera tha se propozoj një sistem të paralajmërimit të hershëm se nga po shkon procesi për t'u mos u befasuar më pas.

**Driton Selmanaj**, në fjalën e tij të sërishme, tha se nuk bën të shkoj jo vetëm unë, por kushdo nga ne nuk bën të shkoj në këtë fazë. Po ashtu tha se me këtë temë nëse do të ketë gadishmëri politike do duhej të kishte marrëveshje mes liderëve të partive politike, sepse mund të ketë nevojë edhe ndryshime kushtetuese.

**Kryetari** tha se nuk pajtohet se mund të ketë konflikt të interesit. Gjithashtu tha se ne e kemi kërkesë dhe mund të procedojmë duke pohuar se është kontribut më shumë profesional.

**Hydajet Hyseni- Kaloshi** tha se grupi i punës për vettingun nuk është në fazën e hartimit të aktit dhe nuk mendon se nuk mund të mos angazhohen bashkarisht. Në praktikën e mëparshme të Kuvendit ka pasur disa raste kur përfaqësues të Kuvendit kanë marrë pjesë në hartimin e koncept- dokumentit të rëndësishëm së tillë.

*Pas diskutimeve anëtarët e komisionit u dakurduan, që kjo pikë të diskutohet në mbledhjen e radhës.*

## **8. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk pati ndonjë gjë për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

-----  
**Adnan Rrustemi**